

JANI THOMAJ

## PROBLEME TË STRUKTURËS FORMALE DHE TË KLASIFIKIMIT TË FRAZEOLGJIZMAVE TË GJUHËS SHQIPE <sup>1)</sup>

Një rol të veçantë në ndërtimin e frazeologjizmave të gjuhës shqipe lot edhe struktura formale, kategoria leksiko-gramatikore e komponentëve; forma e tyre gramatikore, karakteri i marrëdhënieve sintaktike, elementët leksiko-gramatikorë arkaikë, fjalët shërbyese etj., kurse rendi i fjalëve përgjithësisht nuk lot rol kuptimdaltonjës.

§ 1. — Si në gjuhë të tjera, edhe në shqipe shumë frazeologjizma lindin nga krahasimi, përmes metaforës në leksikalizim; kjo është rruga më e zakonshme, p.sh. "ç'm'u bë halë në sy ky hajvan" (Q. Buxheli, "Dueli", Nëndori, 12, 58), e kam halë në sy (pop.); e kam inat si kam inat halën në sy > e kam si halë në sy > e kam halë në sy (e urrej). Krahasimi shpesh herë është i dukshëm, sepse ruhen lidhëzat krahasuese, p.sh. "Për kundrë një mik i lik / s'tregohet kurrë besnik: / dhe kur sillemi të marrë, / na thotë si na vjen mbarë"; "(Çajupi, Vepra, 239); flet si e jem'e Zeqos majë thanës (pop.). Të një natyre me këto janë edhe konstruktet me ndajfoljen *sa*, e cila përdoret në krahasimet për të treguar sasi, madhësi, numur, shkallë, p.sh. "Tregojnë se një maçok / ish i fortë sa s'kish shok." (Çajupi, Mëmëdheu; 107); ". . . retë e bardha që shkëlqenin sa të merrnin sytë." (Nëna e erë-rave, 94); "Të pasur ishim në zift sa s'kish ku të vinte, po me ziftin tonë asfaltoheshin rrugët e Romës e të Parisit, . . ." (Sh. Musaraj, "Përpara agimit", 5); "Kishte vajguri vëndi ynë sa të mbyste botën, po atë e mirnin të huajt, . . ." (po aty); "— ke myshterinj? / — sa të hanë qentë!" (Hosteni; I, 1964, nr. 509, 10); "ngiste sa i hanin këmbët" (pop.); "po s'e bëra Turqinë sa të hajë barë / mos më thëngjin më Ismail Qemalë" (Berat) etj.

Një tip të veçantë formojnë këtu frazeologjizmat si: "i ka hije si shala gomarit"; "i rri punës si voi përmbi ufull" (Fjalor frazeol. anonim); "mos rri ashtu si gur vorri ose si gur'i varrit = thuhet për një njeri që as qesh, as flet dhe rri i vranët e si i zemruem" (Shkolla Kombëtare, Tetuer-Nanduer 1938, nr. 19-20, f. 31); [nus'e lalës] "duke ngrën'e duke pirë, / u bë si kapuç në hirrë". (Çajupi, Mëmëdheu, 107); "se çupa që doje vetë, / të la si gunë e vjetër / dhe mori një burrë tjetër," (Çajupi, Vepra, 241); ". . . i bëtë atentat si kofini pas së vjelash . . ." (Sh. Musaraj, vep. e cit., 50); "Shkoi si çjapi te kasapi . . ." (Th. Frashëri, Trimat nuk vdesin, 4); "u bëre si lakra e bujtur = të ra rëndësia fare: mos hec gjithnjë ke vjerra, se bëhe si lakër e bujtur" (Shkolla Kombëtare, Fruer 1939, nr. 23, f. 39) etj., të cilat shërbejnë si shprehje krahasuese të fakteve të mëparshme (shpesh herë ironikisht), por që në vetvete krijojnë unitete semantike, ekuivalente me fjalët, nga që emërtojnë nocione të vetme. Rrjedhimisht, sipas nesh, ato duhen trajtuar si frazeologjizma të gjuhës.

Lidhëza krahasuese luan një rol të veçantë në organizimin e unitetit frazeologjik tek frazeologjizmat shqipe. Të shprehurit ose të mosshprehurit e saj dhe vendi që ze në konstruktin e togfjalëshit shpesh herë është shënja

1. Me probleme të karakterit të përgjithshëm dhe të strukturës semantike të frazeologjizmave të shqipes jemi marrë në një punim tjetër, shih "Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe", botuar në "Studime Filologjike" Nr. 2, 1964.

d alluese për trajtimin e këtij apo atij togfjalëshi si frazeologjizëm apo si bashkim i lirë fjalësh.

Në rastet kur lidhëza krahasuese nuk shprehet në mes të komponentëve të togfjalëshit, sadoqë mund të nënkuptohet, mungesa e saj lejon formimin e këtij togfjalëshi si frazeologjizëm, p.sh. *është bërë rrogos gruri fare* (ka rënë); breshëri e bëri rretra (copëtoi) duhanin; më je bërë pastërma (je tharë e nxirë); e do qofte ti, po s'ka; m'u bërë ferrë (pop.); " . . u bë pastaj lule plaka"; (Inst. i Shk., vep. e cit., 28); "këpucët janë bërë shosh" (Dielli, 3. VIII' 1916); "se lotët më mbenë pajë, / gjersa të të qasem pranë." (Th. Mitko, Moj Ndino, moj mall'i zjarhtë!, në Antologji e poezisë shqipe të Rilindjes, 46); "Më bëri zëmërnë plagë, / s'më deshi se jam nga baltë;" (Çajupi, Vepra, 96); "Të dhëmb këmba? Bënu burrë / dhe në shtrat mos u nder kurrë;" (po aty, 240); " . . e ke lënë foshnje tani u bë burrë, . . ." (po aty, 64); " . . po zëmëra jote u bë gur për mua!" (po aty, 62); " . . i ishte bërë mëndja veri për të ikur." (Sh. Musaraj, vep. e cit., 29); " . . ndonse me hapa breshke, po përparonin . . ." (po aty, 30); " . . edhe mizën e bënë buall kur është fjala për ndonjë dobësi të saj, . . ." (po aty, 24); " . . ish bërë grusht, e nuk pipëntinte asnjë fjalë." (po aty, 7); " . . kur i shfaqnje dyshimin . . bëhej bishë." (po aty, 45) etj.

Kur lidhëza krahasuese çfaqet nëmes dy komponentëve të frazeologjizmit me dy gjymtyrë, na duket se frazeologjizmi çpërbëhet e kthehet në togfjalësh të lirë, sepse komponenti pas lidhëzës shërben thjesht si gjymtyrë krahasimi për komponentin e parë, p.sh. u bëra si pastërma, e kam si sepap nga babai, m'u bërë si ferrë; "I ziu jam i sëmurë, / më digjet koka si furrë, (Çajupi, Vepra, 82, 101); " . . ai . . e e bëri si burat . . ." (Sh. Musaraj, vep. e cit., 47); " . . marshin edhe nga ditët e mia që e banë si burrat." (po aty, 37); "Emirës i ra si plumb kjo shprehje . ." (po aty, 11) etj.

Përsa i përket unitetit semantik të togfjalëshit në raste të tilla, ai në vija të përgjithëshme duket sikur nuk prishet, por në të vërtetë kemi një kalim nga shkrija semantike e të dy komponentëve për realizimin e një kuptimi (frazeologjik) në një zbërthim të këtij uniteti, me anën e lidhëzës krahasuese, e cila krijon një gjendje të tillë ku në togfjalësh secili komponent realizon një nga kuptimet e tij, qoftë edhe derivat dhe shuma e thjeshtë e këtyre kuptimeve jep kuptimin e togfjalëshit. Këtë kalim mund ta paraqisnim grafikisht në këtë mënyrë:

Rasti i parë, *m'u bërë ferrë*: [V (elementi foljor)+N (elementi jo foljor) =Kf (kuptimi frazeologjik); kllapa katrore tregon se njëzimi semantik është i brendshëm.

Rasti i dytë, *m'u bërë si ferrë*: (V (elementi foljor me një kuptim derivat)+IN (lidhëza dhe elementi jo foljor)=Ktg (kuptimi i togfjalëshit); njëzimi semantik është i jashtëm.

Ky është procesi i dytë, i anasjellur, i kalimit të togfjalëshave pa lidhëzë në togfjalësha me lidhëzë krahasuese, sepse në të vërtetë togfjalëshat me lidhëzën janë primarë e prej tyre kanë dalë togfjalëshat frazeologjikë: *m'u bërë si ferrë* > *m'u bërë ferrë*.

Në rastet kur çfaqet ose nënkuptohet lidhëza krahasuese dhe nuk e çpërbën frazeologjizmin, zakonisht ajo shënon edhe fillimin e tij, p.sh. ruaj si dritën e syrit, e pagoi si frëngu pulën, "gjithnjë bluani si mulliri pa kokrra (Q. Buxheli, vep. e cit., 54) etj. Në këta tipa elementët para lidhëzave (në rastet e dhëna foljet) nuk hyjnë në përbërjen e frazeologjizmave, sepse së pari, u ve kufi formalë lidhëza dhe së dyti, folja nuk shkrihet me kuptimet e elementëve të tjerë në kuptimin tërësor frazeologjik, sadoqë vetë folja mund të ketë këtu një kuptim derivat: e pagoi si frëngu pulën

= e pagoi *shtrenjtë*, bluan si *mulliri pa kokrra* = bluan (=flet) kot etj. Por duhet dalluar rasti kur lidhëza ose ndajfolja sa në shprehjet krahasuese është vetë element përbërës i frazeologjizmit, me që ky ka ardhur nga frazeologjizimi i tërë togfjalëshit, p.sh. *iu ba dhambi sa i kalit* e s'ja dhash (plasi e s'ja dhash) etj.

§ 2. Frazeologjizma në gjuhën shqipe krijohen edhe mbi bazën e hiperbolës: "kufiri ishte armatosur e fortifikuar sa *as shpesi nuk kalonte*"; "më bëhet zemra mal kur mendoj se Borisi im do të shkojë ndonjë ditë si pilot" (Shtëpia e vogël në breg të detit, 19); "e bëj mizën buall (*qimen tra*)"; "shpëtuam nga vapa se na *hëngri të gjallë*"; "iu tha zorra për të ngrënë"; "more e ngriti m' *frymë* Halimin ai" (iu bakrye) (pop.) etj. Në ndërtimin e tyre shpesh çfaqet edhe lidhëza krahasuese.

§ 3. — Në gjuhën shqipe ndërtohen frazeologjizma edhe me anë të përsëritjes së të njëjtit element ose dy elementash të një kategorie leksikogramatikore, p.sh. 1) e zgjodhi grurin *kokërr për kokërr*, vinte *natë më natë*, sivjet do ngrihen ushtarë *bërë e pabërë* parakalimi, gëzuar *kokë për kokë* (të gjithëve), në mbremje *J zënë e pa zënë* dielli *J* mblidhen bagëtia, mos u zemro *kot së koti*, e qëlloi *flakë për flakë*, e kërkoi *pil më pil*, *krah për krah* me partizanët luftuan edhe partizanet, *i dola ballë për ballë*, ma hodhi *sy më sy*, e kemi lënë trashëgim *bres pas brezi* (pop.); "Atë pas ai e gjysh pas gjyshi, *J* farinë tënde nuk ma rrëfen?" (Kal. Komb., 1901, 168-169) etj. Frazeologjizma të tillë kanë në strukturën e tyre patjetër fjalë shërbyese, si parafjalë e lidhëza ose nyje. Po një rol të veçantë lot sidomos forma gramatikore më shpesh e komponentit të radhës së dytë, si tek modeli *bres pas brezi*. Këta frazeologjizma janë më afër kompozitive dhe në shumë raste vetëm fjalët shërbyese e pengojnë procesin e kompozimit të tyre. Mjafton të krahasohen për këtë shembujt: *pikë për pikë* dhe *pika-pika*, *kokërr për kokërr* dhe *kokrra-kokrra*, *natë për natë* dhe *nata-natës* etj. 2) "Ia tregoi *fille për pe*; i bëri punët *lesh e li* (*këmbë e krye*); shtëpinë me *laça e me plaçka* e kishte në fshat; erdhi në dasëm me *kuçkë e me maçkë*; rrinte tërë *hundë e buzë*; jam *thikë e brisk* me të; shkojnë *mish e shpirt*; i bën punët *shkel e shko*; ai flet *qesh e ngjesh*; u lëshue *turr e vrap*; e shkoi jetën *hiq e mos e këput*; *kash'e lashë*; "shtriu krahun *kokë e lëkurë* . ." etj. Duhet vërejtur se në këtë rast komponentët e frazeologjizmave janë fjalë sinonime a të semantikes së ngjashme ose antonime, d.m.th. fjalë semantikiisht korelative. Ngarjherë elementi i dytë i shtohet një frazeologjizmi tashmë të formuar me një folje, me qëllim përforcimi të idesë së shprehur nga frazeologjizmi, p.sh. *bëri be e rrafe* (*lëshoi be e rrafe*) se s'dinte gjë (gja), u bë *pluhur e hi* (u shkretua fare), e *la kamba e dora* (u mplak), *i bëj paratë rrush e kumbulla* (shpenzoj kot) etj. Frazeologjizmat e pikës 1 dhe 2 përbëjnë dhe tipin më elementar nga ana e strukturës formale. Nga ana e strukturës së brëndëshme, sadoqë duken si të zbërtheshëm, ata karakterizohen nga një lidhje semantike e ngushtë nëmes komponentëve, e cila i bën unikë dhe të papërçarshëm. Bie keq në vesh zbërthimi i frazeologjizmit të këtij tipi, si tek shembulli: "ato thash e këto theme *J* janë të kota e të reme" (Ali Asllani, Vidi, vidi pëllumbeshë, 200).

§ 4. — Në gjuhën shqipe, veçanërisht në gjuhën e folur, është mjaft e pasur kategoria e frazeologjizmave që formohen nga një folje me kuptim të përgjithshëm dhe një emër foljor i dalë prej një foljeje tjetër, p.sh. *bëj rrethim* (rrethoj), *bëj pushim* (pushoj), *bëj durim* (duroj), *bëj çkëputje* (çkëputem), *bëj ndjekje* (ndjek), *bëj ndërhyrje* (ndërhyj), *bëj shitje* (shes), *bëj mbrojtje* (mbroj), *merr malcim* (malcon), *ve sqarimin* (sqaroj), *i erdhi ngordhja* (ngordhi) etj.; " . . e kush mbahetë me mos *bam sherbes* këtë ditë . . "

{Buz. XXI 25 a); "Dhe ata u munduan, për [gjith natën s'i dhanë dot vendim." (Inst. Shk., vep. e cit., 91); "dhe njerstë që kishte brënda / *hoqnë mundime të rënda*," (Çajupi, Mëmëdheu, 117); "... mori drejtimin për në shtëpi." (Sh. Musaraj, vep. e cit., 41); "... bënte përpjekje për formimin e një qeverie shqiptare..." (po aty, 44); "... s'kish pasur ndonjëherë lidhje me lëvizjen..." (po aty, 33); "S'kish dyshim që ai ish një nga ata..." (po aty, 34); "... kish kohë që po bënte përçapjet e duhura..." (po aty, 33); "Po mblidh mendën dhe jepi vendim". (po aty, 52); "... shokët kanë besim se ti do të japësh kontributin tënd..." (po aty, 6); "... kur merr vendim "pedagogu" ynë, as djalli s'e tund!" (Mësuesi, 17.I.64, IV) etj. Tek "... u detyrua të japë dorëheqjen." (Sh. Musaraj, vep. e cit., 13, 30) kemi një formim analogjik *jap+dorëheqje* (<heq dorë), sadoqë nuk ekziston akoma në shqipet tema foljore *dorëheq*.

Siç shihet, në përbërjen e këtyre frazeologjizmave hyjnë folje të përdorimit më të shpeshtë (sidomos folja *bëj*), e cila, pasi desemantizohet në një farë shkalle, lot rolin e një foljeje gjysmë ndihmëse. Themi se togfjalëshi në këtë rast rrjedh nga "zberthimi" i një foljeje, sepse elementi i dytë i togfjalëshit (emri foljor), siç dihet, formohet nga tema e asaj foljeje. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për frazeologjizmat, të cilët për komponent të dytë kanë një emër jo foljor ose ndonjë pjesë tjetër të ligjëratës, si p.sh. *bëj ballë* (përballoj), *bëj llafë* (llafosem), *bëj fjalë* (fjalosem), *bëj bisedë* (bisedoj), *bëj dëm* (dëmtoj), *bëj zë* (bëzaj), *bëj mend* (mendoj), *ha ana* (anon), *jap komandë* (komandoj), *vë re* (vërej), "... *dhanë besë* që të përpigënë e të vdesinë për shpetim të mëmëdheut". (S. Frashëri, Shqipëria ç'ka qënë... 1962, 24); "Romanët u *dhanë funt* Frygaset e Thrakaset,..." (po aty, 18); "... erth një komp i vogëlë q'i thoshinë Helen e Grek, e *zu vent* në Greqi..." (po aty, 16); "Shqiptarëtë, ..., *kanë marrë anë* në gjithë luftërat..." (po aty, 33); "Domethënë unëj, kur e gjente pisk, dhe *ngrinte krye*, porsa mblidhte veten." (F. Noli, Historia e Skëndërbeut, 1962, 15); "...nxitohet të *zinte këmbën* e aleates së saj të mundur..." (Sh. Musaraj, vep. e cit., 31); "Po ajo komedi *mori fund* tani." (po aty, 56); "Mos na *shit mënt* — ia ktheu Qemali..." (po aty, 39); "...mundoheshin t'i *bënin bisht* urdhërit të komandës..." (po aty, 40); "Qemali s'donte t'u *zinte besë* syve kur pa në mes të tyre Veledinin." (po aty, 42); "... është lehonë dhe *ka frikë* se mos marrë sysh... (Çajupi, Vepra, 118); "*Bënë ben'* e *dhanë besë*," (K. Hoxhi, "Burro djal" i Shqipërisë", në Antologji e poezisë shqipe të Rilindjes, 70) etj.

Për formimin e këtyre frazeologjizmave në shqipet janë dy rrugë të mundshme: a) Më parë do të ketë ekzistuar togfjalëshi si formë analitike dhe më vonë mbi bazën e tij do të jetë formuar ekuivalenti delokutiv (fjalë e formuar nga përngjitja e komponentëve të një lokucioni<sup>1)</sup>), si rezultat i konglutimit të komponentëve të togfjalëshit, siç del kjo në rastet *vë re* — *vërej*, *bëj zë* — *bëzaj*, *zë vendin* — *zëvendësoj* etj. Po formimi më i hershëm i frazeologjizmit në krahasim me sinonimin një fjalësh është i mundur edhe për rastet kur sinonimi nuk del nga bashkimi i të dy komponentëve të frazeologjizmit, por vetëm mbi bazën e njërit komponent. Kështu, tek Buzuku ne ndeshim: "*Bani bē* zotynë, e të mos pendonetë..." (XII 7 a); "... djerie u *të vë* anëmiqtë e tū *mbë vend*..." (po aty); "E tash *zanë n'fill* Antifenatë e Lavdevet." (XIII 12 a); "E u *zū* *barë* *q* Shpirtit shenjtë."

1) Termi i E. Benveniste, *Les verbes délocutifs*, në "Studia philologica e litteraria in honorem L. Spitzer", Bern 1958, p. 57-63, —sipas Florica Dimitrescu, *Despre verbale "délocutive"*, në "Studii s'i cercetării lingvistice", T. XII, nr. 3 Academia Republicii populare Române, Institut de lingvistică din București, Anul XII, 1961, p. 307-309.

(XV 13 b); "Hinjë se Virgjëna *kā me u bām me barë*, e ka me lēm birë." (XV 14 b); ". . .; ma aj qi *kā shpënesë* mbë Tenëzonë, mishërierja *kā me ngjeruom atë*." (XVI 16 b); ". . . shpirti em *pat shpënesë mbi* Tenëzonë." (XIII 9 ab); ". . .; e aj me gjithë forcë të ti të *mbae shpënesën* tande mbë tÿ . . ." (XX 32 b) etj., — por nuk ndeshim delokutivët ose sinonimet njëfjalëshe të këtyre frazeologjizmave, si *betohem, vendos, mbarset, filloj, shpresoj* etj. Kjo rrugë formimi është e mundëshme, teorikisht, edhe për raste të tjera të kësaj natyre, si *bëj ballë — përballoj, bëj llafe — llafosem, zë besë — besoj, shoh ëndërr — ëndërroj, bëj gati — gatit, bëj dëm — dëmtoj, i jap fund — përfundoj* etj. b) Por është e mundëshme edhe një rrugë tjetër një formim paralel dhe i pamvarur i frazeologjizmit dhe i sinonimit njëfjalësh, mbi të njëjtën bazë (rrënjë a temë produktive), por në stile të ndryshme, si dy mjete (analitike e sintetike) të shprehjes të të njëjtit nocion. Kështu: *ballë—bëj ballë || përballoj* (<përball<për ballë); *anë—ha ana || anon;* *vënd—zë vënd || vendosem;* *dëm—bëj dëm || dëmtoj;* *fund—i jap fund || përfundoj* etj.

Të paktën që nga Buzuku na dokumentohet një zhvillim i tillë paralel: "Aj qi *bām mënī*, aj qi kujtoi keq shoqit e fqinjësë; " (XXII 27b) || "E për shumë mot aj në *u mëniftë*, aj mā me shoq s foli as nukë pajtoi." (XXII 27 a) || "Zot, ti në *mbajtësh mënī*, kush të jetë aj qi të mundë mbahetë?" (XVII 18 b); ". . . ti të *nderīsh* të tū përrind." || "E si me u *bām ndër*." (XXI 26 a); "Mos *kini besë* mbë zotënt, . . ." (XX 24 a) || ". . . ata qi mbë Tenëzonë nukë *besonjënë*." (XXI 25 a); "Lutemi atī qi neve bani e atī qi neve na *ep gjellë*" || "me se *gjellimë*." (XXVI 36 a); "Zot, mos si na të *kemi bām kātne* neve na e kthe." || "E kush mbë këtë mëndyrë *përkātënonetë*, aj *përkātënonetë* ndë e tretët kat . . ." (XXII 28 b) etj.

Na duket se në gjuhën shqipe formimet analitike janë karakteristike më tepër për variantin e folur, kurse formimet sintetike për gjuhën e shkruar.

§ 5. — Lidhur me këtë strukturë semantiko-formale është e vështirë për të dalluar rastet e polisemisë nga rastet kur formohen frazeologjizma. Përgjithësisht është e vështirë të vihet një kufi i prerë nëmes tyre, megjithatë duhet patur parasysh që në polisemi, fjala (që ka fituar kuptim të ri në sajë të lidhjes me një a disa fjalë të tjera) nuk e humbet pavarësinë e saj formale dhe nuk shkrihet kuptimisht me fjalë të tjera për të dhënë me to një kuptim unik e të vetëm, p.sh. *gryka* e shishes, *gryka* e pusit, *zë i lartë*, *zë i ultë*, *hekuri* i rrobave, *kalemi* i shartimit, *lodër* (daullja) etj. . Gjithashtu në fjalën polisemantike shpesh herë kuptimet e reja e kanë humbur deri diku karakterin e tyre figurativo-emocional dhe, në se e kanë këtë, e kanë si element më vehte, jo të lidhur me fjalë të tjera me të cilat bashkëvenë, p.sh. *çerdhe* (fëmijësh), *kopësht* (fëmijësh), *vdëq me gojë*, *pa gojë* (fliste, nuk fliste), *mendje femër* (pjellore) etj. Këto fjalët, në kontekstet e dhëna, realizojnë një nga kuptimet e tyre derivate, pa vendosur marrëdhënie të ngushta semantike të karakterit frazeologjik me fjalë të tjera. Kurse në rastet e togfjalëshave frazeologjike çdo fjalë, goftë dhe fare pak, e ka humbur pavarësinë formale dhe nga ana semantike shkrihet me kuptimin e fjalëve të tjera në një kuptim unik dhe të vetëm, p.sh. *ha ana* (anon), *marr inat* (inatosem), *bëj shaka* etj. Gjithashtu në frazeologjizëm komponentët kanë një karakter figurativo-emocional më të theksuar po t'i marrim veças, por kuptimet e tyre shkrihen së bashku në një kuptim unik, që sinjalizon një nocion të vetëm, p.sh. *rrugë e verbër* (monopat), *më vjen ndër mend* (kujtoj), *merr fund* (përfundon) etj.

§ 6. — Në disa frazeologjizma të shqipes vendi i elementit me kuptim figurativ (kur vetëm njeri është i tillë) nuk lot rol në ndryshimin e kupti-

mit frazeologjik. Bile në një "çerdhe" togfjalëshash të qëndrueshëm frazeologjikë që dalin nga një fjalë bosht, komponenti kryesor herë mund të jetë, herë jo, me kuptim figurativ, p.sh. në rastet *s'më punojnë sytë*, *shoh me bisht të syrit*, *shkel synë*, *ia bëj me sy*, *ngul sytë*, *më mbetën sytë*, *sa çel e mbyll sytë* etj., fjala *sy* është përdorur në kuptimin e drejtpërdrejtë; kurse tek *s'kam sy e faqe*, *sa për sy e faqe*, e *bën për sy të botës*, *s'ma mbush synë*, *mora një sy gjumë*, *s'i trembet syri* etj., fjala *sy* është përdorur në kuptimin figurativ.<sup>1)</sup>

Si komponent bosht, nga pikëpamja formale, në shumë frazeologjizma të gjuhës shqipe janë fjalët e përdorimit të shpeshtë, si foljet *bëj*, *marr*, *kam*, *jam*, *vete*, *bie* etj., emrat e pjesëve të trupit të njeriut, si *dorë*, *këmbë*, *hundë*, *sy*, *buzë*, *gojë*, *ballë*, *qafë*, *dhëmb*, *vesh*, *zemër*, *mendje* etj., fjalë të tjera si *bukë*, *ujë*, *shteg*, *udhë* (rrugë), *dritë*, *mirë*, *keq* etj.<sup>2)</sup> Del se, në një farë shkalle, formimi i frazeologjizmave të gjuhës shqipe lidhet edhe me aftësinë e karakterin e përdorimit të fjalëve të ndryshme në lidhje me fjalë të tjera, padyshim në përputhje me lidhjet dhe marrëdhëniet konkrete të nocioneve në realitet.

§ 7. — Nga ana e kategorive leksiko-gramatikore që marrin pjesë në strukturën e tyre frazeologjizmat e gjuhës shqipe paraqiten të shumëllojshëm. Po kështu të shumëllojshëm janë ata edhe sipas lidhjes sintaktike nëmes komponentëve të tyre. Esenciale është që frazeologjizmat e gjuhës ndërtohen sipas po atyre lidhjeve sintaktike të togfjalëshave të lirë, sipas marrëdhënieve të brendëshme të fjalëve përbërëse të togfjalëshave të lirë, p.sh. *ja ngul sytë*, e *bëj lule* (rrugulloj), *marr më qafë*, *ve dorë*, *nuk rreh veshin* për atë punë, *më ra për thojsh*, *bëj një vesh të shurdhër* etj.

Në gjuhën shqipe më e pasur është kategoria e frazeologjizmave foljore me lidhje objektore, që ndërtohen nga një folje kalimtare dhe një emër në rasën kallëzore a dhanore, p.sh. *thyej qafën*, *kam mëndjen*, *kam kujdes*, *kam turp*, *marr fuqi*, ma *ka koritë mustakun*, *ha hakun*, *t'i biesh këmbës e s'ke për ta marrë* etj.

Po kaq e pasur është edhe kategoria e ndërtimeve me lidhje subjekt-veprim (kryesisht me folje jo kalimtare), p.sh. *erdhi fjala*, *i ka dalë boja*, *s'del yndyrë* nga ky njeri, *i doli fjala* atij; *i erdhi zemra në vend* ma *merr mendja*, *i dogji miza*<sup>3)</sup> etj.

Frazeologjizmat që shprehin marrëdhënie nocionesh të sendeve a fenomeneve përbëhen nga dy a më shumë emra, nga të cilët njëri është në rolin e përcaktuesit për emrin tjetër dhe mund të qëndrojë në rasi të ndryshme, me ose pa parafjalë, p.sh. jeton me *djersën e ballit*, jeton me *thonj të duarve*, punon për *bukën e gojës*, e godit *në lule të ballit* u zgjua *kokër qiçër* (Nëndori, 1962, 3, 129), të ther me *thumb pambuku*, me *ikë tym doset*, *petlla n'ujë* ato që thua, me *litar në grykë* etj.

Marrëdhënie të tilla jo rrallë ndërthuren edhe me marrëdhënie të tjera sidomos me ato objektore e subjekt-veprim, p.sh. *i ka plasur cipa e ballit*, *s'e njuh qeni të zonë*, *mos e bëj mizën buall*, *i pikoi zemra gjak*, *i asht ba mendja kobure*, *m'asht ba shpirti derr (gomar)*, *veri gishtin kokës*, *s'i bihet murit me krye*, *i ngeci sharra në gozhdë*, *të merr gjak nën vetull* ai etj.

1) Është fjala për frazeologjizmat, kuptimi tërësor i të cilëve del nga shuma e kuptimeve të të dy komponentëve, me kusht që njeri i të jetë në kuptimin figurativ, tjetri të drejtpërdrejtë.

2) Mjafton të shihet për këtë rrethi i gjerë i frazeologjizmave të formuar me elementin *sy* dhe *këmbë* në gaz. "Mësuesi", nr. 16 (86), datë 19.IV.1963, f. 3, tek artikulli ynë "Frazeologjia, pasuri e madhe leksikore e gjuhës".

3) Këta shembuj dhe të tjerë më poshtë janë nxjerrë nga Kartoteka e leksikut të shqipes, sipas germave përkatëse. Për shkurtime të punës, për ta nuk po japim shënime të tjera në tekst.

Më të rralla janë në shqipet ndërtimet që shprehin marrëdhënie send-cilësi, p.sh. jam këtu ma e mbramja birë e kavallit, kishte tri ditë me gojë thatë (pa ngrënë), voe të kuqe s'ban (nuk bën mrekullira), e priti me krahë hapët (me qejf, me dashuri), nuk shkel në dërrasë të kalbur, ka le me yll të mirë (është fatlum), të pafsha në rrugë të madhe (fatkeq, të varfër), shtretërit e nxehtë (serre chaude) etj. Edhe këtu këto marrëdhënie ndërthuren me marrëdhënie të tjera sintaktike, kur frazeologjizmi ka më tepër se dy gjymtyrë.

Disa frazeologjizma të shqipes shprehin marrëdhënie nëmes veprimit si proces dhe cilësisë a rrethanës së këtij veprimi, p.sh. ec drejt hundës (shiko punën tënde), i shkon tymi drejt atij, i ra zemra fash, i bie punës prapa, por gjyshja nuk hante shqip' (nuk kuptonte, nuk bindej, Qytetari Brih, V. II, 59), gjermanët aty e paguan shtrenjtë etj. Padyshim, lloji i këtyre marrëdhënieve dhe i kuptimit të frazeologjizmave (vendore, kohore, mënyre etj.) varet nga natyra e ndajfoljes, siç e tregojnë shembujt e mësipërm.

§ 8. — Nga ana e ndërtimit formal, komponentët e frazeologjizmave të shqipes mund të jenë kategorish së ndryshme leksiko-gramatikore. Po përmendim disa nga llojet më produktive:

Emër+emër, p.sh. e goditi në lule të ballit, loçka e zemrës, jemi lidhur me të si mishi me thoin (si mishi me kockën), flet kodra pas bregut, bres pas brezi etj. 1)

Emër + mbiemër, p.sh. pres me zemër të ngrirë, rri me mendje të ngritur, e la me zemër të plagosur etj.

Folje + emër, p.sh. hëngri dajak në mbledhje, vendi e pruri në fuqi, bëj fjalë (grindem), zuri një tufan që s'bëhej hesap etj.

Folje + emër + emër, p.sh. ndaje shapin prej sheqerit, ja bani punën li-vadh (facilitare), ma bani mizën ka (buall), kur hante qeni pagaq, i pikon zemra gjak, bëj bir në shpirt, i ka zanë rrota bishtin, i kanë ra trutë në qafë, tashti ra e drejta në mes (është njësoj për të gjithë) etj.

Foljet + emër + mbiemër, p.sh. voe të kuqe s'ban, nuk sike! në dërrasë të kalbur, ka le me hyll të mirë etj.

Folje + folje, p.sh. endu e shendu (ec e jak), ky është fol e qesh, qesh e ngjesh etj.

Folje + dajfolje, p.sh. e pagoi shtrenjtë, e le (punën) zvarrë, i bie (punës) prapa, s'hante shqip, bie poshtë (ky mendim), u ramë përpara (i udhëhoqëm), më vjen keq, vete bosh ("Vepra më duket e mirë, / tha, po vete bosh, / ç' do ta bëj këtënë" (Çajupi; Mëmëdheu, 60), ". . shkolla vajti mbroth . . ." (Kalendari Kombiar 1900, 63) etj.

1) Në frazeologjinë e gjuhës shqipe ndeshet edhe një tip struktural kryesisht frazeologjiz-mash emërorë, që burojnë nga forma foljore, nëpërmjet të kthimit të komponentit foljor në emër foljor, p.sh. "Me ty ashtë të zanelë t'fill q ditet se vertytsë sate, . ." (Buz. XII 7 a); "Nga këto mbledhje u hoqnë telegrafe në Berlin, për të protestuar kundër dhënjesë vent nga Shqipëria . ." (Kalendari Kombiar, 1903, 80); ". . kombi shqipëtar gjendetë më një zjar të madh e më një gjëndje të keqe që mund të shpjerë dishprimin më një pikë sa të sjellë derdhje gjak dhe zjar të tmeruarë, . ." (id., 85); Mjaft me gjumën e të huajt, o ju padijës, mjaft me të hequrit më nj'anë ju o frikashë!" (ib. 88); "Nga të pasurit synë në punëra të mbretërisë . ." (Ditërrëfenjësi Kombiar, 1900, 41); ". . kjo tregon mos pasjen kujdes nga ana e ndërmarrjes . ." (Bashkimi, 18/II/1947, II); "Përveç që përkrahin reaksionarët indianë në hedhjen poshtë të zgjidhjes paqësore të çështjes së kufirit kino-indian . ." (Zëri i Popullit, 3/XI/1963, IV, konstrukt i tipit emër foljor + ndajfolje); "Me ta vënë në përdorim . ." (Q. Buxheli, vep. e cit., 49) etj. Si në gjuhën e folur ashtu dhe në atë të shkruarën konstrukt i emër foljor sufik-sal + komponent jo foljor është më i dëndur, kurse ai emër foljor asnjëherë + komponent jo foljor na duket se përputhet më tepër me natyrën e shqipes, p.sh. ngulja këmbë — të ngulurit këmbë, marrja parasysh — të marrurit parasysh etj. Për të dy rastet, që të mos epërbëhet fra-zeologjizmi, duhet që komponenti i dytë (jo foljor) të mbetet i ngurosur në trajtën që ka në modelin fillestar, si tek dhënia vent, derdhja gjak, të pasurit synë, ngulja këmbë — të ngulurit këmbë, marrja parasysh — të marrurit parasysh etj. Të krahasohen këto me tipin foljor fillestar: i jap vend, derdh gjak, kam synë, ngul këmbë, marr parasysh etj.

**Ndajfolje + Ndajfolje**, p.sh. *sot për sot, me sot me nesër, me ra gjallë e ngushtë, flet mbarë e mbrapshtë* etj.

Këto janë kombinimet më të zakonshme dhe më produktive në gjuhën shqipe. Po skemat e kombinimeve janë më të shumta, si *emër + pjesore* (flas me ballë hapur, mbeti me gojë hapur etj.), *emër + mbiemër + emër* (unë jam brima e fundit e kavallit këtu), *folje + mbiemër* (bëhem in johur etj.), *numror + emër* (një pesë para burrë, për pesë pare spec etj.), *numror + numror* (dualën një e një = barabar, pa një pady etj.), *folje + numrorë* (ja bëri tetë me dy, sa të thuash pesë = shpejt etj.), *emër + numror + emër* (mësallë me dy faqe etj.), *folje + emër + numror* (u ba mendja nji etj.) etj. Më të pasurit në gjuhën shqipe janë tipat *folje + emër, folje + emër + emër* dhe *folje + ndajfolje*.

Kuptimi i frazeologjizmit në shqipet nuk varet aq nga kategoria leksikogramatikore e komponentëve përbërës, se sa nga një lidhje e brendëshme e tyre. Kështu, vlera e frazeologjizmit, për nga funksioni emërtonjës, mund të mos jetë e barabartë me atë të komponentëve, p.sh. flet *kodra pas bregut* e pagoi si *frengu pulën* (emër+emër)=frazeologjizma ndajfoljorë; po kështu: me i dalë për zot, me i dhanë zemër, me ba namë, mos me ça kryet, me vue gojë (kritikoj) etj. (folje+emër) = frazeologjizma foljorë etj.

§ 9. — Numri i tipave formalë të togfjalëshave frazeologjike rritet me kombinimet e reja që krijohen me pjesëmarrjen edhe të parafjalëve e lidhëzave të ndryshme që hyjnë në ta, si dhe me ndryshimin e rendit të fjalëve.

Në gjuhën shqipe janë të paktë frazeologjizmat që kanë një rend të detyrueshëm fjalësh (kryesisht idiomat, si *vë re, marr vesh, bëj pallë, i jap dum* punës etj.). Kurse përgjithësisht rendi i fjalëve në frazeologjizmat e shqipes është relativisht i lirë dhe varet nga natyra e fjalisë ku ata hyjnë, nga funksioni ekspresivo-emocional i tyre etj. Mëgjithatë ligjet dhe rregullat e lidhjeve sintaktike të togfjalëshit të lirë ruhen edhe në ndërtimin e frazeologjizmave të shqipes. Pra, në shumicën e rasteve rendi i fjalëve nuk përbën një element kuptimndryshonjës<sup>1)</sup> të frazeologjizmave shqip; ai ose nuk ja ndryshon fare kuptimin frazeologjizmit (me përjashtim të nuanceve ekspresive-emocionale), ose shpie në formimin e një konstrukti të pakuptimtë a të papërdorshëm: bashkime fjalësh si: *re vë (vë re), vesh marr (marr vesh), li e lesh (lesh e li), breg pas kodrash (kodra pas bregut)* etj. nuk janë fakte gjuhësore të shqipes.

§ 10. — Lidhja e brendëshme sintaktike nëmes komponentëve të frazeologjizmave në shqipet është e detyrueshme, e domosdoshme, si dhe për togfjalëshin e lirë. Kjo lidhje sintaktike në bashkimet e qëndrueshme është përfuruar historikisht dhe ka arritur në një shkallë të tillë, sa që elementët kanë humbur pavarësinë krejtësisht (tek idiomat) ose pjesërisht (tek bashkimet frazeologjike). Duke e marrë frazeologjizmin si njësi të vetme (si një fjalë) ahere ai mund të hyjë lirisht, ose jo, në një lidhje me fjalë të tjera. Nga kjo pikëpamje dallohen në shqipet frazeologjizmat me lidhje të detyrueshme dhe ato me lidhje të lirë në fjali. Karakteri i detyrueshëm i lidhjes në disa frazeologjizma të gjuhës shqipe me lidhje të detyrueshme në fjali vjen, së pari, nga që ata nuk mund të përdoren në të gjitha rastet analoge me rastin fillestar, p.sh. "votoni për këtë kërkesë në duhet hedhur

1) Duhet përjashtuar ndonjë rast i rrallë, si tek "e them me plot gojën" (me bindje, i bindur), ku ndryshimi i rendit të fjalëve "e them me gojën plot" do të na ngatëronte me kuptimin e togfjalëshit të lirë, "e them me gojën mbushur,,.

në votë a *duhet hedhur në shportë*" (gaz. Dielli, 1916), lutjen time e *hodhi në shportë* (nuk e pranoi) etj. Kjo shprehje mund të përdoret vetëm për mos-pranimin (mosaprovimin) e lutjeve e kërkesave që janë të shkruara dhe jo në çdo rast kur kemi të bëjmë me lutje e kërkesë, p.sh. nuk mund të thuhet: "e luta shokun të vemi në kinema, po ai lutjen time e *hodhi në shportë*", "i kërkoja shitësit të m'i zgjidhte mollët, por kërkesën time ai e *hodhi në shportë*" etj. I tillë është edhe frazeologjizmi "s'i mbajta qirinë (*pishën*)", i cili përdoret vetëm për çeshtje nderi!).

Së dyti, nga që disa frazeologjizma të shqipes kur hyjnë në fjali duhet të përshtaten në rasë, numur, kohë, vetë etj. me fjalët e tjera, p.sh. ai *s'do t'ia dijë*, *s'donte t'ia dinte*, ata *s'duan t'ia dinë* etj. Së treti, nga që disa frazeologjizma të shqipes kanë ose vetëm kuptim pohor, ose vetëm kuptim mohor. Me kuptim vetëm mohor janë frazeologjizma të tillë si "ky djalë *s'le dy gurë bashkë*" (nuk mund të thuhet: kurse ky tjetri le dy gurë bashkë), "nuk e bëj qefin qeder", "s'më zinin këmbët dhë" (nuk thuhet: e bëj qefin qeder, më zinin këmbët dhë), "atij s'i shohin më sytë për dasma", "s'ia hante qeni shkopin" etj. (Në këto shprehje mohuesja (nuk, s') hyn në përbërjen e frazeologjizmit si element i domosdoshëm. Gjatë të shprehurit me intonacion pyetës - eksklamativ këta frazeologjizma formalisht e humbasin mohuesen s', nuk (kthehen në formën pohore), megjithatë ruajnë gjithnjë kuptimin mohor (në trajtë pyetëse), p.sh. "pse le dy gurë bashkë ai?" (d.m.th. *nuk le dy gurë bashkë*), "pse e bën qefin qeder ai?"; "m'u prish puna mua!" (=nuk m'u prish puna) etj. Kjo gjë ndodh edhe me frazeologjizma të tjerë, që kanë formë pohore dhe mohore, p.sh. *ve mend*, *s've mend* — *pse ve mend ai?* *merr vesh* — *s'merr vesh* — *pse merr vesh ai?* etj. Me kuptim vetëm pohor janë frazeologjizma të tillë si "e bëj lesh e li," "m'u bë mendja dhallë", "hapi sytë" (nga çudia), "hap veshët!" (dëgjo) etj.

Karakteri i lirë i lidhjes në frazeologjizmat me lidhje të lirë në fjali në gjuhën shqipe vjen gjithashtu, së pari, nga që disa frazeologjizma mund të përdoren në çdo rast analog me rastin fillestar, p.sh. *i kthej kurrizin* (braktis) shtëpisë, prindërve, shokëve, punës etj.; *nxjerr nga balla* — për çdo rast kur ne ndihmojmë a shpëtojmë dikë a diçka nga një gjëndje e vështirë; *kam gisht* — kur kam marrë pjesë në çfarëdo pune a akti, të keq etj. Së dyti, nga që disa frazeologjizma të shqipes nuk përshtaten sipas rasës, numrit, gjinisë, kohës, vetës etj. të fjalëve të tjera në fjali, d.m.th. lidhen me ato pa ndryshuar formën, p.sh. unë e bëj punën *shkel e shko*, (ti / ai) e bën punën *shkel e shko*, ne e bëmë punën *shkel e shko* etj.; ti (ai) flet *qesh e ngjesh*, ju flisni *qesh e ngjesh*, flet (flasim, flisni, folën) *qodra pas bregut* etj. Të tillë janë në gjuhën shqipe kryesisht frazeologjizmat e tipit ndajfoljor. Fakti që ata hyjnë lirisht në lidhje me fjalë të tjera në fjali pa qënë nevoja të përshtaten me to flet për karakterin ndajfoljor të tyre dhe anasjelltas, karakteri ndajfoljor i tyre shpjegon aftësinë që kanë ata për të hyrë lirisht në lidhje me fjalë të tjera. Së treti, karakteri i lirë i lidhjes në frazeologjizmat me lidhje të lirë në fjali vjen edhe nga që disa frazeologjizma të shqipes mund të kenë edhe formën pohore dhe formën mohore dhe, përkitazi me to, kuptimin pohor dhe mohor, p.sh. (ma) ha *mendja* — s'(ma) ha *mendja*, (ma) do *zemra* — s'(ma) do *zemra*, (ma) prishi *qefin* — nuk (ma)

1) Një kufizim të tillë kanë edhe fjalët në bashkimet e lira, si *odes-ngordh*, *lind-pjell*, *shitazanë-barsë* etj.; karakteri i lirë i lidhjeve të tyre me fjalë të tjera është relativ, sepse kushtëzohet nga kufizimi i sferës së përdorimit të tyre.

*prishi qefin*, (më) *sh'kon nëpërmend* — nuk (më) *shkonte nëpërmend* etj. Në konstruktin e frazeologjizmave të tillë mohuesja (*s'*, *nuk*) paraqitet element i domosdoshëm për jetën e frazeologjizmit dhe nuk njësohet me komponentët e tij, prandaj ajo nuk përfshihet në strukturën e së tërës.

§ 11. — Një farë roli në karakterin strukturalo-semantik të disa frazeologjizmave të shqipes lozin edhe elementët arkaikë leksiko-gramati2 korë.

Në disa frazeologjizma të shqipes ruhen elemente arkaike gramatikore; p.sh. më *doli hundëshit* (rrjedhorja *në-shit*); *marr më sysh* (tek Çajupi *marr sysh*: "Kur e she, zonja Briri që është lehonë dhe ka frikë se mos *marrë sysh*, shtrihet në stomë pranë foshnjës që ka pjellë" — Vepra, 118); e *hëngri më sysh*, e *mori më qafë*, i *bie më gjunjë* (lutem) (përdorimi i parafrjalës *më*) etj. Kategoritë gramatikore si këto janë elemente kuptimdallonjese ose frazeofornjese, krah. *marr më qafë* dhe *marr në qafë*, *marr më sysh* dhe *marr në sysh* (?)

Tek shembujt: ". . . ia vlen barra qirasë t'i vështrosh nga të gjitha anët." (L. Obuhova, Qyteti i largët, 1957, 211), "Unë tani e kuptova se ja vlen barra qirasë të shoqëroresh me ju." (N. Nasov, Aventurat e Din Pakut, 1957, 136), "Piku vrau mëndjen në ja vlen te barra qirasë të binte në gjunjë" (T. Popoviç, Etja, 1962, 562) "s'ja vlen barra qirasë të mëresh me kalamaçjtë" (Myz.) etj., — arkaike është marrëdhënia e trajtës së shkurtër të përemrit në rasën kallëzore (*e*) me emrin *qira* në dhanore. Kurse tek shembujt: ". . . s'ia vlen te barra qiranë të përmendej." (J. Krimov, Tankeri Derbent, 1961, 31), "As që ja vlen barra qiranë të hyjmë në polemikë për këtë çështje". (R. Brahimi. Fjalë për letërsinë, 1960, 61) etj., — arkaike është marrëdhënia e trajtës së shkurtër të përemrit në rasën dhanore (*i*) me emrin *qira* në kallëzore. Siç duket, në të dy rastet kemi një përzjerje të trajtave *e vlen barra qiranë* (formë e drejtë dhe e dokumentuar, shih dhe Fj. Gj. Shq., 1954, 615) dhe *i vlen barra qirasë* (formë jo e drejtë dhe e padokumentuar), përzjerje që në të dy rastet është pasqyruar në shkrimin e trajtave *i + e* > *ia*.

Ndër disa frazeologjizma të gjuhës shqipe, karakteri arkaik përcaktohet nga elementë leksikorë të huaj ose shqip, që nuk kanë jetë si njësi më vehte në sistemin e leksikut të shqipes, por vetëm si njësi përbërëse të frazeologjizmave, p.sh. *vë re*, e *humbi toruan*, ". . . ish në bend të mirë . . ." (Sh. Musaraj, vep. e cit., 15); ". . . s'e bëj has = s'e kam qejf" (Çajupi, Mëmëdheu, 145); më *ra bretku* në punë", "ky miell s'ka duk" (pop.), "i jap dum (çështjes, — Fj. Gj. Shq. 1954, 96), "shëtiti mal e arbën" (kudo, — F. Cordignano, Fj. Shq. — it.), *bëj pallë*, etj. Disa prej këtyre komponentëve kanë në shqipe një kuptim të ndryshëm nga rrënja e tyre (si *pallë* krah. me gr., *bretku* krah. me *bretku* në Fj. Gj. Shq. 1954/46 "mashkulli i bretkosës", *re*, krah. me *rëndë-*, *rëndësi* etj.)

Frazeologjizmat e këtij lloji janë mjaft kompaktë, sepse qartësia e elementit të dytë përcaktohet pikërisht nga afria me foljen; veçimi ose largimi nga folja e bën të qartë ose të pakuptueshëm komponentin tjetër. Prandaj edhe nga ana formale këta komponentë janë unikë e s'duhet të ndahen nga elementët të tjerë.

Të kësaj natyre janë edhe frazeologjizmat e gjuhës që kanë si komponent një fjalë turke të pandryshueshme ose që në shqipe nuk ka jetë si njësi më vehte, p.sh. *bëj selam*, *dola në selamet*, *bën vaki*, *bëj kail*, *kam zët*, *bëj hallall*, *s'kam qeder*, më zuri *qederi*, *bëj derman*, *s'kam gajle* u *bë helaq*, *bëj kabull*, *mbetet batall*, *bëhem hazër*, na u *bë syri mangërr*, *bëj*

tojbe etj. Po në shqipet janë më të shumtë frazeologjizmat që kanë në përbërjen e tyre fjalë turke, të cilat bëjnë pjesë në leksikon tonë edhe si njësi më vete ose që marrin pjesë në ndërtimin e disa frazeologjizmave, p.sh. *zë pusi, bie në pusi, bëj pusi, i vë pusinë* (Fj. i Gj. Sh., 441), *sjell në terezë*, aty ja *kam shtënë terezinë* për të rritur derrat (më duket më mirë, ve synë — Skrapar), *bëj gryshat, bëj rrezil, bëhet akshëm*, m'u *bë se bep këmba* (më dhimte), *gjej se bep, u kall damllanë arave* (Pogr.), *esolli në hatër, i është bërë mëndja havale* (Pogr.), *bëj harxhë* (Ber.), *bëj sehir*, këto shenja *kanë bërë vakiat* shumë herë (Skrapar), *bëj dava, bëj hall* (rregulloj, gjej), më *zuri halli, s'kam hall, kam hakë, heq merakun, kam zili, kam katat, bëj hatanë* etj. Përgjithësisht fjalët e tilla turke janë historizma në leksikon e shqipes, por ato ruhen mirë ndër frazeologjizma, shumë prej të cilëve i gjejmë edhe në gjuhën e shkruar. Po elementi turk në frazeologjizmat e shqipes u jep atyre një farë karakteri arkaik.

Si përfundim mund të themi se elementët arkaikë leksiko-gramatikorë në frazeologjizmat e gjuhës shqipe, lozin rol edhe frazeformonjës edhe kuptimdallonjës.

§ 12. — Rol frazeformonjës dhe kuptimdallonjës në frazeologjizmat e shqipes ka përgjithësisht edhe ngurosja e formave, fosilizimi i njërit nga komponentët në një trajtë të caktuar. Një ngurosje të tillë kemi tek *vë re* për komponentin e dytë; "unë po bëj ç'më *vjen doresh*" (Q. Buxheli, vep. e cit., 67) për komponentin e dytë; "n'e *dërgofsha n'atë jetë, / die, do të të marr vetë!*" (Çajupi, Vepra, 55) për komponentin *atë*; "ngop në *dru*", "dënd në *dru*", etj. për parafjalën *në* etj. Pra, ngurosja duhet të kuptohet me të gjitha format e saj: në pamundësinë që njeri komponent të ndryshojë trajtën, karakterin e marrëdhënive me komponentët e tjerë, rendin dhe distancën etj. Rastet e kundërta mund të të çojnë ose në çpërbërjen e frazeologjizmit, ose në një togfjalësh me kuptim të pamundshëm, ose në një togfjalësh të lirë a frazeologjik me kuptim tjetër (krh. *ngop në dru* dhe *ngop me dru, marr më sysh* dhe *marr në sy, luaj mënj* dhe *luaj mëndjen* etj.)

Lidhur me ngurosjen e trajtës së komponentëve të frazeologjizmave në shqipe dallohen këto variante: 1) Kur komponenti nuk ka formë tjetër të mundëshme, p.sh. *bëj durim, bëj fjalë* (emrat s'mund të vihen në të shquarë), *bëj detyrën, (i) bëj varrin* (emrat s'mund të vihen në të pashquarë); 2) kur komponenti ka më tepër se një formë të mundëshme, që pasohen nga kuptime frazeologjike të reja, p.sh. *bëj qejf* dhe *bëj qejfin*, *marr erë* (nuhas, di) dhe (i) *marr erën, hap synë* (llastoj) dhe *hap sytë, ta merr mëndja* dhe *ta merr mëndjen, i jap udhë* (punës) dhe *i jap udhët* (djalit, përzë)<sup>1)</sup>; 3) kur komponenti mund të ndryshojë formën pa e prishur kuptimin frazeologjik, p.sh. *bëj betim-in, bëj luftë-n, "më qan syri / më qajnë sytë /* për një cikë qejf" (Skrapar), *bëj gjumë-in* (e parë) etj. Ndryshimi i kuptimit frazeologjik mund të vijë edhe si pasojë e pranisë së elementëve të tjerë (lidhëza, parafjalë etj.), që në këto raste janë njësi të domosdoshme të strukturës së frazeologjizmit, p.sh. "u mblodhën *kokë më kokë / "gëzuar kokë për kokë"* (pop.), "ve mend / "ve në mend", *marr mëndjen e . . / marr me mend / (i) marr mëndjen / ma merr mëndja* etj.

Në gjuhën shqipe, krahas frazeologjizmave që nuk durojnë një ndër-futje (interkalim) të fjalëve të tjera nëmes komponentëve të frazeologjizmit, ka edhe frazeologjizma, që jo vetëm pranojnë elemente të tjera nëmes

1) Shih edhe M. Çeliku, *Togfjalësha të qëndrueshëm foljorë në shqipen e sotme*, Bul. Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shkenc. Shoq., 1962, II, 243.

komponentëve, por edhe i kërkojnë, sadoqë këto elemente nuk përbëjnë gjymtyrë të frazeologjizmit; kështu, p.sh. e *le punën zvarrë* (zvarris) (pop.), *i bie punës prapa* (pop.), e *merr vdekjen në sy*, e *mora ligësinë në sy*, s'ua *merr dot anën* etj. janë më të natyrshëm se variantet "e *le zvarr punën*, *i bie prapa punës*, s'ua *merr anën dot*" etj. Nga këta duhet të dallojmë frazeologjizmat që kanë në përbërjen e tyre elemente të domosdoshme për strukturën formale e të brendshme të tyre, p.sh. "i *binte herë gozhdës herë patkoit* dhe inatosej me vehten e tij", "as të *stoh as të ngroh*" (pop.), mos *fli me atë mendje* ti (pop.), "ta *dërgoj n'atë jetë*" etj.

§ 13. — Një anë tjetër formale që lot rol të rëndësishëm në konstruktimin e frazeologjizmave të shqipes është edhe prerja, cungimi, kur njeri komponent, meqenëse merret me mend, nuk shprehet. Në shqipet dallohen dy raste: së pari, kur mungesa e komponentit nuk e prish frazeologjizmin, sepse mbeten dy ose më shumë komponentë të tjerë të bashkimit, p.sh. të *merr gjak* (+ në *vetull*), ja *mblodhi këmbët* (+ në një *këpucë*), *ka mizën* (+ në *kësulë*), *ashtu i do mushka* (+ *drutë*), e *bëj djalë* (+ në *shpirt*), *i hedh hi* (+ *syve*), " . . këta të dy të paudhë / m' *mbluadhë retat* (+ e *djepit*) shumë" (Kalendari Kombiar, 1904, 170); "Ka shumë mundësi që të *vijë në udhë* (+ të *mbarë*) dhe të ndreqet" (Sh. Musaraj, vep. e cit., 30) etj.; së dyti, kur mungesa e komponentit e prish frazeologjizmin, sepse mbetet vetëm një komponent, p.sh. atij ashtu ia *do* (+ *puna*), mua *kaq ma pret* (= mendja), ja *mblodhi* (= *rripin*), s'ua *thotë* (+ mendja), s'ua *kap* (+ mendja), " . . ish *kaq* i shqetësuar sa, edhe sonte natën të gjente mjet, *do ja mbathte* . . ." (+ *këmbëve*, Sh. Musaraj, vep. e cit., 29); " . . lëvizni vithjet si ato çingitë që ta bien në majë të hundës përpara se të të *jepen* ." (+ në *dorë*, po aty, 32); "Se fundi i fundit di t'ua *mbledhë* (+ *rripin*, *retrat* etj.) edhe nxënësve, . . ." ("Mësuesi", 17.I.64, IV) etj.

Si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin, komponentët, ose komponenti që mbetet pas prerjes së frazeologjizmit, marrin përsipër tërë ngarkesën semantike të modelit fillestar, kështu që *ja u mbath* = *ja u mbath këmbëve*, *kaq ma pret* = *kaq ma pret mendja*, *ka mizën* = *ka mizën në kësulë* etj.

§ 14. — Disa frazeologjizma të gjubës shqipe nga ana e strukturës formale mund të jenë edhe fjali (d.m.th. mund të formohen nga emra, folje, mbiemra, ndajfolje e fjalë shërbyese), p.sh. e *bëj veshin të shurdhër*, do punoj *sa të kem këmbë e duar*, tashi e *gjeti kokën e kandilit*, *bëmë qysh je tek je me të gjithë*, s'e *ha atë kokërr ulliri unë*, *kalli ujkun që ta hajë atë të mirë* së nga *hundët të delte*; as që *çaj kryet për atë punë*, ja *dha këpucët në dorë*, të merte reja ca si këtej dhe *hapu det të mbytem* pastaj, vdiq i shkreti dhe ja *curi rezenë shpisë*, kur të *bëhen zemrat një ahere* s'do ketë gënjeshtër<sup>1)</sup> etj. Edhe pse nga ana formale kemi të bëjmë në këto raste me fjali, togfjalëshi frazeologjik nuk e humbet karakterin *emërtonjës*<sup>2)</sup>. Frazeologjizmi nuk kryen funksionin e një fjalie (të shprehë gjykim), po të një fjale të vetme (të emërtojë një proces). "Në këtë mënyrë, — shkruan V.V. Vinogradov, — unitetet frazeologjike janë vetëm ekuivalentë të fjalëve, ato janë përbërje sintaktike origjinale fjalësh, paraqiten ose si pjesë të fjalisë, ose si fjali të tëra. Prandaj ato hyjnë në kategoritë gramatikore si njësi kuptimore unike"<sup>3)</sup>. Më poshtë V.V. Vinogradov përcakton edhe rrugën e lindjes së këtij tipi frazeologjizmesh: në gjuhën ruse: "Njësia frazeologjike shpesh

1) Shembuj të mbledhur në zona të ndryshme të Shqipërisë, gjatë ekspeditave leksikologjike; shih kartotekën e leksikut të shqipes.

2) Shih J. Thomaj: "Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe", në "Studime Filologjike", Nr. 2. 1964. f. të gjin faqja.

3) V.V. Vinogradov. art. i cit., f. 24

herë krijohet jo aq nga karakteri figurativ i kuptimit të një radhe fjalësh, se sa nga specializimi sintaktik i frazës, nga përdorimi i saj në një formë gramatikore të fiksuar rreptë”<sup>1)</sup>. Në shqipe një fenomen analog.

\* \* \*

Edhe për klasifikimin e frazeologjizmave të gjuhës, në linguistikën botërore sot ka mendime të ndryshme. Klasifikime të ndryshme janë dhënë, duke patur për bazë kritere të ndryshme. Mjafton të krahasohen për këtë klasifikimet e Ch. Bally, R. A. Budagov, V.V. Vinogradov, N.B. Amosova, N.M. Shanski etj. (shih artikujt e cituar). Duke patur parasysh veçoritë semantiko-strukturale të frazeologjizmave të shqipes dhe karakterin e formimit të tyre, na duket se edhe për frazeologjinë e gjuhës shqipe mund të përshtatet në vija të përgjithshme, klasifikimi i akad. V.V. Vinogradov<sup>2)</sup>. Duke u mbështetur në motivimin ose mosmotivimin e frazeologjizmave, në karakterin figurativ të komponentëve të tyre, në strukturën e brendëshme dhe në ngulosjen e komponentëve e të konstruktit, në frazeologjinë e shqipes ndeshim pak a shumë co ata tipa: idioma ose përngjitje frazeologjike, njësi frazeologjike dhe bashkime frazeologjike. Megjithatë, e themi që këtu, studime të mëtejshme të frazeologjisë shqipe mund të çojnë edhe në një klasifikim të ri më të drejtë e praktik të këtij materiali.

§ 15. — *Përngjitjet frazeologjike (idiomat)*.— Karakteristikë themelore e përngjitjeve është pamundësia për t'u zbërthyer semantikisht, pamundësia absolute për të nxjerrë kuptimin e së tërës nga komponentët. Përngjitja frazeologjike paraqitet një unitet kuptimor, e njëvlerëshme me fjalën, e çveshur nga forma e brendëshme. Ajo nuk është as produkt as shuma e kuptimit të elementëve. "Ajo është një bashkim kimik i disa pjesëve leksikore që janë të shkrira, dhe nga pikëpamja e gjuhës së sotme amorfe<sup>3)</sup>. Kështu, përngjitjet frazeologjike dallohen më tepër për shkrirjen e brendëshme të komponentëve. Kjo lidhje e brendëshme në aspektin e *sotëm të zhvillimit të gjuhës* (pa hyrë në konsideracione historike), nuk duket. Pra, idiomat karakterizohen nga mungesa e motivimit. Nuk mund të vërtetojmë sot se për ç'arësye dhe në ç'rrugë është realizuar lidhja e fjalëve *bëj* dhe *pallë* për të dhënë kuptimin frazeologjik "rri rehat, bëj qejf etj." Nuk mund të zbulojmë ndonjë lidhje nëmes fjalëve *ve* dhe *re* (idioma *ve re*) dhe kuptimit frazeologjik *shikoj*, që rrjedh nga bashkimi i tyre. Mungesa e motivimit i bën idiomat të pazbërthyeshme në komponentët përbërës. "Në kuptimin e tyre nuk ka asnjë lidhje, bile të mundëshme me kuptimin e elementëve përbërës. Nëqoftëse elementët e tyre përbërës shqiptohen njësoj me ndonjë nga fjalët e veçanta e të pavarura të gjuhës, ahërë kjo lidhje është qartë homonimike".<sup>4)</sup> Nga kjo del qartë se shprehje idiomatike janë edhe frazeologjizmat që kanë vetëm një kuptim të mundshëm, atë frazeologjik: *bëj emër* (urdhëroj), *bëj ballë*, *shes mend* etj. Në kuptimin neutral të komponentëve këto bashkime fjalësh nuk kanë kuptim të mundshëm.

Idiomat përbëjnë shkallën më të lartë të ngulosjes dhe, si rrjedhim, në to elementët kanë humbur pavarësinë. Ato kanë humbur kuptimin fillestar, përdoren vetëm në kuptimin figurativ, që shkrihet në kuptimin tërësor frazeologjik. Në kuptimin frazeologjik nuk bën pjesë asnjë prej kuptimeve të drejtpërdrejta të komponentëve.

1) *Po aty*, fq. 25

2) V.V. Vinogradov, *në art. e cit.*

3) Shih tek R.A. Budagov, *vep. e cit.*, 102

4) V.V. Vinogradov: *vep. e cit.*, fq. 23

Ngusorja e elementëve në idiomat duket edhe në faktin se ato përgjithësisht nuk ndryshojnë formën, nuk ndryshojnë vendin, nuk mund të zëvendësohen nga sinonimet koresponduese dhe nuk pranojnë elemente të tjera nëmes tyre.

Idiomatike janë dhe disa shprehje që përmbajnë ndonjë element të pa kuptimtë a të pandryshueshëm kur veçohet, p.sh. e *humbi toruan*, i *jap dum* (punës) etj., si dhe ata frazeologjizma që rrjedhin nga episode, fabula a ngjarje historike të panjohura sot, si : flet si e *jëm'e Zegos majë thanës*, e *humbi si Xhaferi simiten*, shkoi *dushk për gogla*, i *bie legenit* etj. Tek idiomat, gështja e motivimit në plan historik përbën edhe problemin themelor në studimin e tyre. Përngjitjet frazeologjike më shumë se tipat e tjerë shprehin specifikën kombëtare, ato nuk mund të përkthehen në gjuhë të tjera fjalë për fjalë. Pamundësia e idiomave për t'u përkthyer nga një gjuhë në tjetrën, është e lidhur ngushtë me veçoritë e vetë idiomave: me pamundësinë për t'u zëbërthyer, për të nxjerrë elementet nga kuptimi i së tërës, me karakterin figurativ specifik të tyre etj. Në gjuhën shqipe idiomat përbëjnë tipin më të varfër.

§ 16. — *Njësitë frazeologjike*. — Për dallimin e njërive frazeologjike nga idiomat V.V.Vinogradov shkruan : "Nëqoftëse brenda unitetit frazeologjik do të ruheshin qoftë edhe shenja të dobëta të mundësisë së veçimit semantik të komponentëve, nëqoftëse do të ekzistojë qoftë edhe një aluzion i fshehur në motivimin e kuptimit të përgjithshëm, ahëre do të jetë e vështirë të flasim për përngjitje"<sup>1</sup>). Këta frazeologjizma nga ana semantike gjithashtu janë të pandashëm dhe gjithashtu janë shprehje e një kuptimi unik e të tërë, por në ta ky kuptim tërësor është i motivuar, duke qenë një produkt që del nga shkrirja e kuptimeve figurative të komponentëve leksikorë. Po grupin më të pasur në shqipet këtu e përbëjnë frazeologjizmat që kanë dalë nga transformimi figurativ i togfjalëshave të lirë. Njësitë frazeologjike afrojnë me idiomat se janë ekuivalentë semantikë të fjalëve, se komponentët përbërës janë të gjithë në kuptim figurativ dhe se nuk mund të përkthehen tekstualisht në gjuhë të tjera. Por ndryshojnë prej tyre në disa anë të tjera :

Njësitë frazeologjike janë më të motivuara dhe kanë karakter figurativ më të qartë. Në njësitë frazeologjike dallohet lidhja nëmes kuptimit tërësor të shprehjes dhe kuptimit të komponentëve veçmas. Fjalët në një farë mënyre e ruajnë pavarësinë kuptimore dhe formale. Kjo gjë jep mundësinë që i njëjti bashkim fjalësh të jetë edhe bashkim i lirë edhe bashkim i qëndrueshëm. Pra, njësitë frazeologjike janë bashkime fjalësh me dy kuptime të mundëshme: kuptimi i drejtpërdrejtë i bashkimit (të lirë) që bëhet bazë (semantemë) për kuptimin frazeologjik (të njësisë frazeologjike), p.sh. Shqipërinë e mori Turku / i *vu zjarrë* (Çajupi); Revizionistët e sotëm duan të *hedhin ballë* mbi Partinë tonë; *me i dhanë armët* (me u dorëzue), e *zgjidhi qesenë* (pagoi bujarisht) etj. Ky është dhe motivimi i njërive frazeologjike: qartësia e marrëdhënies nëmes kuptimit direkt të bashkimit të fjalëve dhe atij figurativ. Kur fjalët hyjnë në lidhje me kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë ahëre s'kemi frazeologjizëm, p.sh. "ai nuk lexonte, po *kthente fletët* e librit pa vemendje . . .". E njëjta lidhje fjalësh bëhet njësi frazeologjike sapo komponentët përdoren në kuptimin figurativ, p.sh. qe me ne por e *ktheu fletën* (tradhëtoi). Po kështu: *ze kokën me dorë* (fizikisht — bashkimi i lirë) dhe *zë kokën me dorë* (nga tmeri, çudia — njësi frazeologjike); *lëshoj pe* (nga lëmshi — bashkim i lirë) dhe i *lëshoj pe* dikujt (bëj

1 ) V.Vinogradov: *vep. e cituar*, fq. 24

lëshime — njësi frazeologjike); *hëngri kokën* (e qëngjit të pjekur — bashki- i lirë) dhe *ia hëngri kokën* me të mirë (njësi frazeologjike) etj.

Pra, njësitë frazeologjike për nga forma e jashtëme tingullore e tyre mund të përputhen me bashkime të lira fjalësh.

Njësia frazeologjike është një e tërë, kuptimi i së cilës përcaktohet nga kuptimi i komponentëve dhe zakonisht është kuptim metaforik. Lidhja e brendëshme figurative përcakton edhe kuptimin e njësive frazeologjike në tërësi. Kjo gjë kushtëzon edhe ngjyrën emocionale që kanë njësitë frazeologjike: *i ve vetulla e i nxjerr sytë, i bëj paratë rush e kumbulla* etj.

Një dallim tjetër nga idiomat është se në njësitë frazeologjike ngurosjat e komponentëve në një trajtë nuk është e plotë, deri diku ata e ruajnë pavarësinë e tyre dhe mund të ndryshojnë vendin, formën, mund të zëvendësohen nga sinonime koresponduese, mund të pranojnë të tjera fjalë në mes, pa çenuar kuptimin frazeologjik, p.sh. *nuk shkel në dërrasë të kalbur* — *nuk shkel ai kurrë në dërrasë të kalbur*; *''këmbën e t'et rreh të zërë* (N. Frashëri: Hist. e Skënd. 62); *los letrën e fundit* — *los kartën e fundit* — *los gurin e fundit*; *s'ka kohë për atë punë* — *s'ka krye për atë punë*; *i zuri rrota bishtin* — *i zuri qerrja bishtin* etj.

Njësitë frazeologjike përbëjnë tipin më të pasur në gjuhën shqipe dhe më me interes nga pikëpamja leksikologjike.

§. 17. — 3. *Bashkimet frazeologjike*. — Është gjithashtu një tip mjaft i gjerë. Afrohen me përngjitjet dhe njësitë frazeologjike, sepse shprehin një kuptim të vetëm, unik, por ndryshojnë mjaft prej tyre:

Nga ana e motivimit bashkimet frazeologjike qëndrojnë në shkallën më të lartë. Këtu jo vetëm duket lidhja nëmes kuptimit tërësor dhe kuptimit të komponentëve, por, në një farë mënyre, kuptimi frazeologjik del si shumë e kuptimit të komponentëve, me kushtin që një fjalë përdoret në kuptimin figurativ, tjetra në kuptimin e drejtpërdrejtë, p.sh. *bëj durim, bëj qejf, ha ana, shoh ëndërr, bëj pushim, bëj fjalë* (flas), si dhe tek termat e përbërë *koha e mesme, pikë e vdekur, shtylla kurrizore* etj.

Komponenti që ka kuptimin figurativ është më i qëndrueshëm, ai nuk lëviz, përbën boshtin e bashkimit frazeologjik (p.sh. folja *bëj* më sipër). Me të bashkohet një element tjetër. Pikërisht elementi me karakter figurativ, pasi desemantizohet, — dobëson, zbeh kuptimin leksikor dhe përforcon atë gramatikor, d.m.th. kthehet në një folje gjysmë-ndihmëse, — përcakton *karakterin* frazeologjik të bashkimit, bën që kjo lidhje fjalësh të jetë frazeologjizëm. Nëqoftëse edhe ky element do të ketë kuptim të drejtpërdrejtë, ahëre nuk formohet frazeologjizëm, po bashkim i lirë fjalësh, p.sh. *bëj një shtëpi* etj.

Nga ana tjetër, komponenti me kuptimin e drejtpërdrejtë është më i lëvizshëm, ndërrohet dhe ka rol kuptimdallonjës në frazeologjizëm, d.m.th. përcakton *kuptimin* frazeologjik. Në fund të fundit dallimi semantik midis shprehjes *bëj durim* dhe *bëj qejf* etj. përcaktohet pikërisht nga dallimi në semantikën e fjalëve *durim* dhe *qejf*. Kështu, kur përdor bashkimet frazeologjike, folësi e ndjen kuptimin e veçantë të fjalëve përbërëse. Kur edhe elementi i dytë ka kuptim figurativ ahëre kemi idiomë ose njësi frazeologjike, p.sh. *i bëj ballë, i bëj bisht, i bëj gropën (varrin), i u bë këpucë* (i u lut shumë, s'iu nda), *mos u bëj urë e vig* etj.

Veçori tjetër dallonjëse e bashkimeve frazeologjike është se elementët përbërës këtu kanë më tepër pavarësi kuptimore e formale dhe shkalla e ngurosjes së tyre është mjaft e ulët. Kështu dhe jashtëbashkimet fjalët mund të mbartin po ato kuptime (qoftë edhe figurative), më lehtë mund

të zëvendësohen me sinonimet e tyre, të ndryshojnë formën e vendin dhe të pranojnë fjalë të tjera në mes. Kjo vjen nga që lidhja nëmes komponentëve përbërës ndër bashkimet frazeologjike është mjaft e dobët. Këtu është vërtetë të vihet një kufi i prerë nëmes rasteve të polisemisë dhe frazeologjisë<sup>1)</sup>. Për këtë duhet patur parasysh se edhe bashkimet frazeologjike, sikurse idiomat, shkojnë drejt njësimi të kuptimit, shpesh herë nuk e arrijnë këtë njësim deri në fund: ato sikur mbeten në gjysmë të rrugës, krijojnë të tilla bashkime, të cilat lehtësisht zërthehen në fjalë të veçara dhe brenda të cilave fjalët nuk humbasin pavarësinë e tyre<sup>2)</sup>. Në një rrugë të tillë janë p.sh. formimet relativisht të reja *bie temperatura*, *bie çmimi*, *këpuçë me qafa* etj.

Ruajtja e pavarësisë së fjalëve përbërëse duket dhe në faktin se kuptimi i tyre në bashkim është i pakushtëzuar. Bile edhe kuptimi i fjalës jo të lirë mund të perifrazohet, të veqohet ose të shprehet me sinonim. Kështu *bie çmimi* = *ulen çmimet* etj. Nga kjo pikëpamje raste të tilla nuk janë larg nga polisemia e lindur për shkaqe linguistike, si *grykë topi*, *këmba* e *tavolinës*, i *bie violinës* etj.

Por nga ana tjetër, një tipar që na shtyn t'i cilësojmë formime të tilla si kalimtare për në grupin e bashkimeve frazeologjike është edhe se komponentët e tyre nuk kanë të njëjtën aftësi për të hyrë në lidhje me fjalë të tjera të së njëjtës sferë. Kështu, p.sh. thuhet në shqipe: *më kapi frika*, *inati*, *tmeri*, *të qeshurit* etj. por nuk mund të thuhet: *më kapi qejfi*, *kënaqësia*, *urrejtja* etj., sadoqë janë fjalë që gjithashtu shprehin emocione a gjendje shpirtërore të njeriut. Kjo tregon se një farë lidhje e detyrueshme dhe e qëndrueshme ekziston edhe në bashkime të tilla.

Bashkimet frazeologjike më lehtë se çdo tip tjetër mund të kalojnë nga një gjuhë në tjetrën si huazime strukturale. Prandaj huazimet frazeologjike në shqipe janë kryesisht të këtij tipi. "Bashkimet frazeologjike veprojnë me forcën e elementëve të vet të veçuar mbi kuptimin e përgjithshëm, ndërsa idioma ka para së gjithash një kuptim unik. Prandaj idiomat janë shumë shpesh të pa përkthyeshme fjalë për fjalë në një gjuhë tjetër, kurse bashkimet frazeologjike kalojnë relativisht lehtë"<sup>3)</sup>.

## P Ë R F U N D I M

Nga gjithë sa u tha më sipër del kjartë se sa e gjerë është problematika e studimit të frazeologjisë së gjuhës; këto tregojnë gjithashtu se frazeologjia e gjuhës shqipe është një fond po aq i vjetër dhe po aq i rëndësishëm sa edhe fjalët. Ekzistenca e frazeologjizmave të gjuhës në shqipet dokumentohet që me shkrimet e para, madje shpesh herë si formime më të hershme se njësitë leksikore sinonime me ta. Si dhe vetë gjuha ata janë një produkt historik, e, për pasojë, janë zhvilluar e ndryshuar krahas leksikut dhe gjuhës shqipe në përgjithësi.

Në ndryshimet në strukturën e jashtme e të brendëshme të frazeologjizmave të shqipes dhe në shtresat e tipat e tyre, pasqyrohet, si në leksikun e shqipes përgjithësisht, vetë zhvillimi i gjuhës. Por ndryshimet semantiko-formale të frazeologjizmave të gjuhës janë nga më të shumëllojshmet: fonetike, leksiko-semantike, morfologjike, sintaktike, stilistikore etj.

1) Për dallimin e rasteve të polisemisë nga rastet e formimit të bashkimeve frazeologjike jemi shprehur më sipër.

2) Shih edhe R.A. Budagov, *vep. e cit.*, fq. 102.

3) Shih tek R.A. Budagov, *po aty*.

Prandaj edhe studimi i frazeologjisë së gjuhës në tërësi dhe në të gjitha aspektet në një punim të vetëm, si tani edhe në të ardhmen do të ishte mjaft i vështirë dhe jo praktik. Nga ana tjetër, shtruarja e problemeve dhe e tendencave të zhvillimit të frazeologjisë shqipe në një plan të tillë dhe në një prizëm të tillë si në këtë punim, jo vetëm nuk i jep fund studimit të tyre, por përkundrazi kërkon thellim të mëtejshëm për të dalë në konkluzione më të plota e më objektive. Megjithatë, nga vërejtjet tona të gjertanishme mbi materialin e grumbulluar frazeologjik të shqipes, çështje të tilla si dallimi i togfjalëshave frazeologjike nga togfjalëshat e lirë, dallimi i fjalës si njësi leksikore nga frazeologjizmi nga pikëpamja e formës së brendëshme, dallimi i frazeologjisë së gjuhës nga ajo letrare e përgjithësisht nga fjalia nga pikëpamja e funksionit, motivimi ose mosmotivimi i frazeologjizmave, karakteri figurativ i komponentëve, karakteri emërtonjës i frazeologjizmave të gjuhës etj. janë padyshim problemet më themelore për përcaktimin e vetë kufijve të frazeologjisë së gjuhës.

Materiali i grumbulluar gjër tani na çon edhe në disa përfundime të natyrës semantiko-formale, të cilat shprehin tendencën dhe veçoritë e zhvillimit të strukturës së jashtme e të brendëshme të frazeologjizmave të gjuhës shqipe. Të tilla përfundime, të cilat mund t'i shënojmë që tani, janë: në gjuhën shqipe rol frazeofomnjës ose kuptimdallonjës kanë elementët formalë leksikorë (njësitë leksikore), morfologjike (fjalët shërbyese, kategoritë gramatikore të rasës, numrit, trajtës, vetës etj., format gramatikore arkaike, kategoria leksiko-gramatikore e komponentëve etj.) dhe sintaktikë (marrëdhëniet brendafrazeologjike të komponentëve dhe lidhja e frazeologjizmave me fjalë të tjera, roli sintaktik i komponentëve, — krh. *ta merr mendja* dhe *ta merr mendjen*, — prerja ose cungimi i togfjalëshave dhe më rrallë rendi i fjalëve) etj. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim lot edhe ngrirja historike e disa formave të fjalëve, ngurosjja e togfjalëshave në tërësi, formimi i disa frazeologjizmave nga ngjarje historike, episode etj.

Ndërsa semantema e frazeologjizmave të shqipes, qoftë në plan historik qoftë në gjendjen e sotme, mund të zbulohet, proceset e brendëshme dhe tendencat e zhvillimeve kuptimore gjatë kalimit nga semantema në realizimin e kuptimit frazeologjik janë kaq të shumta e të ndryshme, sa që çdo rast do të mund të krijonte një tip më vehte me karakteristika të veçanta. Por një skemë e thjeshtëzuar mund të ndërtohej, duke marrë për bazë fokusin semantik të frazeologjizmave të tipave të ndryshëm (emërorë, mbiemërorë, foljorë e ndajfoljorë), cili komponent përbën boshtin semantik të frazeologjizmit dhe deri në ç'masë merr pjesë semantikiisht komponenti tjetër në realizimin e kuptimit frazeologjik. Për disa tipa strukturalë kjo çështje është më e qartë, si tek *bres pas brezi*, *shkel e shko* etj. dhe deri diku tekbashkimet frazeologjike, në të cilat fokus semantik është komponenti me kuptim të drejtpërdrejtë. Po në tipa të tjerë problemi është shumë më i komplikuar dhe zgjidhja e tij mbetet detyrë e studimeve të ardhëshme.

Nga materialet që kemi pasur në dorë dhe që janë parashtruar pjesërisht në këtë punim, rezulton se tipat më të pasur e më produktivë në shqipet janë frazeologjizmat foljorë nga pikëpamja leksiko-gramatikore, frazeologjizmat e dalë nga transformimi figurativ i togfjalëshave të lirë nga pikëpamja e formës së brendëshme, frazeologjizmat *folje + emër* nga pikëpamja e formës së jashtme dhe njësitë frazeologjike nga pikëpamja e klasifikimit të përgjithshëm të frazeologjizmave të gjuhës shqipe. Por të pasura janë edhe kategoritë ndajfoljore, formimet me përsëritjen e së njëjtës fjalë ose të dy fjalëve të së njëjtës kategori leksiko-gramatikore, tipi i formuar nga shkrija semantike e një fjale në kuptim figurativ me një fjalë në kuptim të drejt-

përdrejtë, d.m.th. bashkimet frazeologjike. Frazeologjizmat emërorë e mbiemërorë, formimet *fjalë me kuptim figurativ + fjalë me kuptim figurativ*, konstruktet me komponentë jo verbalë dhe idiomat në klasifikimin e përgjithshëm nuk janë aq të pasur e karakteristike në gjuhën shqipe.

Edhe nga shembujt e dhënë në këtë punim duket se frazeologjia e gjuhës shqipe është një pasuri e rëndësishme mjetesh emërtonjëse dhe ekspresive, në etapa historike të ndryshme dhe në stile të ndryshme. Frazeologjizmat shprehin nocione që nuk kanë emërtim tjetër, përmbajnë nuanca të veçanta kuptimore-emocionale që s'i kanë koresponduesët e tyre sinonimikë, njësitë njëfjalëshe. Sikurse leksiku në përgjithësi, madje në një shkallë edhe më të lartë, frazeologjia karakterizon stilet e ndryshme të gjuhës. Veçanërisht varianti i folur i gjuhës shqipe është mjaft i pasur me frazeologjizma. Kjo pasuri vazhdon të bëhet pronë edhe e gjuhës së shkruar. Por nëmes stileve të gjuhës së shkruar shqipe ka ndryshime nga mënyra e përvehtësimit të frazeologjizmeve të gjuhës së folur dhe nga mënyra e krijimit të frazeologjizmeve të reja sipas modeleve popullore apo të huaja, nga mjetet dhe konstruktet që pasurojnë fondin e frazeologjisë në përputhje me kërkesat e stilit etj. Por edhe ky problem vetëm sa ceket këtu dhe trajtimi i tij më i plotë i përket një punimi të veçantë.

Zgjidhja e këtyre problemeve të frazeologjisë së gjuhës shqipe ka edhe një rëndësi praktike,— për pasqyrimin e saj në fjalorë të tipave të ndryshëm.

## R é s u m é

### PROBLEMES DE STRUCTURE DE FORME ET DE CLASSEMENT DES CONSTRUCTIONS PHRASEOLOGO- GIQUES\* EN ALBANAIS

*L'existence des constructions phraséologiques en albanais est documentée dès les premiers textes de l'albanais, même souvent comme des formations plus anciennes que les unités lexicales qui leur sont synonymes. Tout comme la langue, elles sont un produit historique, et, par conséquent, elles ont évolué et changé du même pied que le lexique et la langue albanaise en général.*

*Dans les changements de structure extérieure et intérieure des constructions phraséologiques en albanais, dans leurs couches et leurs types, est reflété, au même titre que dans le lexique de l'albanais en général, le développement même de la langue. Cependant, les changements de forme sémantique des constructions phraséologiques de la langue sont des plus variés : ils sont de nature phonétique, lexico-sémantique, morphologique, syntaxique, stylistique, etc. Aussi, l'étude de la phraséologie en général et sous tous ses aspects dans une seule monographie serait assez difficile et nullement pratique. D'autre part, la position des problèmes et des tendances de développement de la phraséologie albanaise sur un tel plan et sous un tel aspect que le travail ci-dessus, loin d'épuiser le sujet, exige par contre un approfondissement ultérieur en vue l'aboutir à des conclusions plus exhaustives et plus objectives. Néanmoins les observations faites jusqu'à maintenant sur le matériel phraséologique de l'albanais permettent de faire ressortir nettement des questions telles que : la distinction des groupes de mots phraséologiques des groupes de mots libres;*

\*) Par construction phraséologique l'auteur entend une expression qui est l'équivalent sémantique d'un seul mot.

la distinction du mot comme unité lexicale de la construction phraséologique au point de vue de la forme intérieure ; la distinction de la phraséologie de la langue de celle de la langue littéraire, et, en général, della proposition au point de vue de la fonction ; la motivation ou non des constructions phraséologiques ; le caractère figuré des composants ; le caractère d'énonciation des constructions phraséologiques de la langue, etc. Et ce sont là les problèmes fondamentaux permettant de délimiter les bornes mêmes de la phraséologie de la langue.

La matériel glané à tout ce jour porte aussi à des conclusions de nature de la forme sémantique, qui expriment la tendance et les particularités de développement de la structure extérieure et intérieure des constructions phraséologiques de la langue albanaise. De telles conclusions, qui peuvent être formulées dès maintenant, sont: en albanais un rôle de formation de la phrase ou de distinction du sens ont les éléments de forme lexicale (les unités lexicales) morphologique (les mots qui rentrent dans leur composition, les catégories grammaticales du cas, du nombre, de la forme, de la personne, etc. les formes grammaticales archaïques, la catégorie lexico-grammaticale des composants etc.) et syntaxique (les rapports à l'intérieur de la phrase des composants et les liens des constructions phraséologiques avec d'autres mots, la part syntaxique des composants, - cfr. ta merr mendja et ta pret mendjen, - la découpe ou la mutilation des groupes de mots, et, plus rarement, l'ordre les mots) etc. Une part importante en ce sens a également la fixation historique de quelques formes de mots, la fixité des groupes de mots en général, la formation de certaines constructions phraséologiques à la suite d'événements historiques, épisodiques, etc.

Tandis que le sémantème des constructions phraséologiques de l'albanais, peut être découvert aussi bien sur le plan historique qu'à l'état actuel, les processus intérieurs et les tendances des développements sémantiques pendant le passage du sémantème à la réalisation du sens phraséologique sont aussi nombreux et variés, qu'en tout cas pourraient se créer des types en-soi, ayant des caractéristiques spéciales. Quoiqu'il en soit, l'on peut construire un schéma simplifié : en prenant comme base le foyer sémantique des constructions phraséologiques de différents types (nominatifs, surnominatifs, verbaux et adverbiaux) : quel composant constitue l'axe sémantique que de la construction phraséologique et dans quel mesure participe sémantiquement l'autre composant dans la réalisation du sens phraséologique. Cette question est plus claire pour certains types structurels, comme chez brez pas brezi, shkel e shko, etc. et, dans une certaine mesure, aussi chez les groupements phraséologiques, où le foyer sémantique est le composant de sens direct. Mais, chez d'autres types, le problème est si compliqué que sa solution est une tâche des études futures.

Des matériaux que l'auteur a glanés et dépouillés, et dont il fait état partiellement dans cette étude, il résulte que les types les plus riches et les plus productifs de l'albanais sont les constructions phraséologiques verbales au point de vue lexico-grammatical, les constructions phraséologiques issues de la modification figurative des groupes de mots libres au point de vue de la forme intérieure, les constructions phraséologiques verbe + nom au point de vue de la forme extérieure, les unités phraséologiques au point de vue du classement général des constructions phraséologiques en albanais. Mais riches sont aussi les catégories adverbiales, les formations à l'aide de la répétition du même mot ou de deux mots de la même catégorie lexico-grammaticale, le type formé par la fusion sémantique d'un mot au figuré avec un mot de sens

direct, c'est-à-dire les groupements phraséologiques. Les constructions phraséologiques nominales et surnominales, les formations mot au figuré + mot au figuré, les constructions à composants non-verbaux et les idiomes dans le classement général ne sont pas aussi riches et caractéristiques à l'albanais.

Il ressort parfaitement, aussi des exemples donnés dans ce travail, que la phraséologie de l'albanais est d'une grande richesse de moyens nominaux et expressifs à différentes étapes historiques et à différents styles. Les constructions phraséologiques expriment des notions qui n'ont pas d'autre évocation, contiennent des nuances particulières sémantico-émotionnelles que n'ont nulle part leurs correspondants synonymiques, les unités d'un seul mot. Tout comme le lexique en général, même à une plus haute échelle, c'est la phraséologie qui caractérise les différents styles de la langue. Le langage courant albanais est notamment riche en constructions phraséologiques. Cette richesse passe de plus en plus dans le domaine de la langue écrite. Toutefois, parmi les styles de la langue albanaise écrite, il y a des différences aussi de par la façon d'assimiler les constructions phraséologiques de langage et de la façon à créer des nouvelles constructions phraséologiques d'après les modèles populaires ou étrangers, de par les moyens et les constructions qui enrichissent le fonds de la phraséologie en concordance avec les exigences du style, etc. Ce problème également n'est que simplement abordé, car son traitement à fond dépasserait les limites de cette étude.

La solution de ces problèmes de la phraséologie de la langue albanaise a aussi une importance pratique : celle de leur reflet dans les dictionnaires de l'albanais.